



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:064300

Datë: 04.12.2024

Numri i dokumentit: 06548190

Rev.nr.538/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar, Mr.sc. Muhamet Rexha dhe Zenel Leku, anëtar, në çështjen kontestimore të paditëseve Gj. A., M. A., F. H., S. H. dhe M. Q., që të gjitha nga Gj., të cilat me autorizim i përfaqëson i autorizuari Arbër Guta, avokat në Gj., kundër të paditurës Qeveria e Kosovës – Ministria e Shëndetësisë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, për kompensimin e shtesave mujore mbi pagën bazë, duke vendosur përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.6104/2022, datë 24.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 03.12.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si i palejuar revizioni i të paditurës, Qeveria e Kosovës – Ministria e Shëndetësisë, Rr.... Nr..., ..., P., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.6104/2022, datë 24.07.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm, C.nr.375/2021, të datës 24.07.2022, ishte vendosur si në vijim: " I. Aprovohet e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëseve Gj. A., M. A., F. H., S. H. dhe M. Q., që të gjitha nga Gj. dhe detyrohet e paditura Qeveria e Kosovës – Ministria e Shëndetësisë, që paditëseve të lartcekura, t'ua paguajë shumën si vijon:

- Padi tëses Gj. A., në emër të kompensimit të shtesave mujore mbi pagën bazë për muajt Korrik 2020, Gusht 2020, Shtator 2020, Tetor 2020, Nëntor 2020 dhe Dhjetor 2020 (për çdo muaj nga 100.00-€), të i'a paguaj shumën e përgjithshme prej 600.00 euro.
- Padi tëses M. A. në emër të kompensimit të shtesave mujore mbi pagën bazë për muajt Korrik 2020, Gusht 2020, Shtator 2020, Tetor 2020, Nëntor 2020 dhe Dhjetor 2020 (për çdo muaj nga 100.00-€), të i'a paguaj shumën e përgjithshme prej 600.00 euro.
- Padi tëses F. H., në emër të kompensimit të shtesave mujore mbi pagën bazë për muajt Korrik 2020, Gusht 2020, Shtator 2020, Tetor 2020, Nëntor 2020 dhe Dhjetor 2020 (për çdo muaj nga 100.00-€), të i'a paguaj shumën e përgjithshme prej 600.00 euro .
- Padi tëses S. H. në emër të kompensimit të shtesave mujore mbi pagën bazë për muajt Korrik 2020, Gusht 2020, Shtator 2020, Tetor 2020, Nëntor 2020 dhe Dhjetor 2020 (për çdo muaj nga 100.00-€), të i'a paguaj shumën e përgjithshme prej 600.00. euro.
- Padi tëses M. Q., në emër të kompensimit të shtesave mujore mbi pagën bazë për muajt Korrik 2020, Gusht 2020, Shator 2020, Tetor 2020, Nëntor 2020 dhe Dhjetor 2020 (për çdo muaj nga 100.00-€), të i'a paguaj shumën e përgjithshme prej 600.00. euro.

E të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit për secilën padi tëse, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë (01.04.2021) deri në pagesën definitive të detyrimit, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm

II. DETYROHET e paditura që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, padi tësve të iu paguajë shumën prej 1,163.20.-€ (njëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre euro e njëzet cent), në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.6104/2022, datë 24.07.2024, "I.REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Qeveria e Kosovës - Ministria e

Shëndetësisë, e përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, ndërsa pika I dhe II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.375/2021, të datës 22.07.2022, vërtetohet. II. Pika II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, C C.nr.375/2021, të datës 22.07.2022, mbetet e pa shqyrtuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura ka paraqitur revizion, për shkak shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen dhe kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pa bazuar.

Paditësit, përmes të autorizuarit avokat Arbër Guta nga Prishtina, kanë paraqitur përgjigje në revizion duke kërkuar që revizioni të hedhet si i pa lejuar për shkak të vlerës së vogël të kontestit.

Gjykata Supreme e Kosovës, fillimisht në kuptim të nenit 211.2 të LPK-së, shqyrtoi lejueshmërinë e paraqitjes së revizionit, dhe gjeti se:

Revizioni i të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Shëndetësisë është i palejuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se gjykata e shkallës së parë, e kishte aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Paditëset Gj. A., M. A., F. H., S. H. dhe M. Q., të cilët kanë parashtruar padi kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Shëndetësisë, për kompensimin e shtesave mujore mbi pagën bazë. Të njëjtit gjatë tërë kohës së pandemisë kanë qenë në “vijën e parë të fronit” në luftën ndaj pandemisë Covid-19, duke u ballafaquar çdo ditë me pacientë të infektuar e të cilët janë për shërim në Spitalin Rajonal “I. G.” në Gj..

Gjykata e shkallës së parë, secilës paditëse veç e veç i kishte aprovuar kërkesën në emër të kompensimit të shtesave mujore mbi pagën bazë për muajt korrik 2020, gusht 2020, shtator 2020, tetor 2020, nëntor 2020 dhe dhjetor 2020 (për çdo muaj nga 100,00 euro), t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 600,00 €, për secilin nga paditësit.

Me nenin 211.2 të LPK-së, parashikohet se revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike, në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po qe se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk e kalon shumën prej 3.000.00 €.

Numri i lëndës: 2021:064300

Datë: 04.12.2024

Numri i dokumentit: 06548190

Për faktin se me revizion është goditur aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, për kompensimin e dëmit të gjykuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila nuk e kalon shumën e paraparë me dispozitën e nenit 211.2 të LPK, për secilin nga 2 paditësit veç e veç, të cilët janë bashkëndërgjygjës të thjeshtë, revizioni në këtë çështje juridike nuk është i lejuar dhe si i tillë duhet të hidhet poshtë.

Në bazë të asaj që u tha e me zbatimin e nenit 221 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.538/2024, datë 03.12.2024

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami